

MAIN
***Multilingual Assessment Instrument
for Narratives***

N. Gagarina, D. Klop, S. Kunnari,
K. Tantele, T. Välimaa,
U. Bohnacker & J. Walters

Albanian

Translated and adapted by
Enkeleida Kapia

(based on the revised version in English)

© ZAS Papers in Linguistics 64 (2020)

How to cite this version:

Gagarina, N., Klop, D., Kunnari, S., Tantele, K., Välimaa, T., Bohnacker, U. & Walters, J. (2019). MAIN: Multilingual Assessment Instrument for Narratives – Revised. Materials for use. *ZAS Papers in Linguistics*, 63. Albanian version. Translated and adapted by Kapia, E.

MAIN: Albanian

Instrumenti vlerësues shumëgjuhësor i aftësive tregimtare në gjuhën shqipe

Enkeleida Kapia¹

Instrumenti vlerësues shumëgjuhësor i aftësive tregimtare në gjuhën shqipe është hartuar në vitin 2012 me qëllim që të vlerësojë aftësitë tregimtare të fëmijëve që përvetësojnë një a më shumë gjuhë qysh nga lindja ose që në moshë të hershme. Ky instrument u krijua fillimisht për fëmijë nga mosha 3 deri në 10 vjeç, por kohët e fundit studime të ndryshme të cilët kanë përdorur këtë instrument kanë treguar që mund të përdoret edhe për fëmijë më të rritur, adoleshentë dhe të rritur. Mënyra e hartimit të tij lejon vlerësimin e të kuptuarit dhe të prodhuarit (të të shprehurit) të tregimeve në disa gjuhë tek i njëjti fëmijë, përmes mënyrave të ndryshme të elicimitit (angl. different elicitation modes): a) Përralla e treguar nga vlerësuesi/eksperimentuesi (përralla e modeluar), b) Tregimi e përrallës (e cila nuk është modeluar më parë) dhe c) Ritregimi (i përrallës së treguar). Versioni i vitit 2012 është hartuar në bazë të pilotimit të gjerë me më shumë se 500 fëmijë monolingualë dhe bilingualë të moshës 3 deri në 10 vjeç, për 15 gjuhë dhe kombinime të ndryshme gjuhësh.

Në vitin 2019, versioni në anglisht u rishikua në bazë të mbi 2,500 tregimeve të MAIN (angl. Multilingual Assessment Instrument for Narratives) të transkriptuara, si dhe rreth 24,000 përgjigjeve të pyetjeve, po të MAIN, rreth të kuptuarit të përmbajtjes, të mbledhura nga rreth 700 fëmijë monolingualë dhe bilingualë në Gjermani, Rusi dhe Suedi midis viteve 2013-2019. Versioni aktual i gjuhës shqipe, mbështetet në versionin më të fundit të vitit 2019 në anglisht.

Instrumenti vlerësues shumëgjuhësor i aftësive tregimtare në gjuhën shqipe përmban katër tregime/përralla paralele, secila i ilustruar me kujdes me një sekuencë prej gjashtë vizatimesh, mbështetur mbi një model shumëdimensional të organizimit të tregimeve. Përrallat janë përshtatur/gjetur përsa i përket kompleksitetit konjitiv dhe gjuhësor, për paralelizmin në makrostrukturë dhe mikrostrukturë, si edhe për përshtatshmërinë kulturore.

Edhe pse *Instrumenti vlerësues shumëgjuhësor i aftësive tregimtare në gjuhën shqipe* nuk është standardizuar ende, procedurat e tij të standardizuara mund të përdoren për vlerësim, për ndërhyrje klinike dhe për kërkim shkencor. Për informacion më të detajuar se si të përdoret ky instrument, lutemi të shihni kapitullin "*Background on MAIN – Revised, how to use it and adapt it to other languages*" (shkruar në anglisht) në *ZAS Papers in Linguistics* 63 (2019, f. iv- xii), i cili mund të aksesohet këtu: <https://zaspil.leibniz-zas.de/issue/view/53>.

Ky dokument përmban:

- Udhëzime për përdorimin e testit si mjet vlerësues
- Protokollet, Fletët e vlerësimit për *Macen, Qenin, Zogjtë e vegjël, Kecat*
- Të dhëna personale
- Skenaret e përrallave

¹ I jam tejet mirënjohëse Xhulia Samanta Dule për punën e saj të palodhur për këtë variant të *Instrumentit vlerësues shumëgjuhësor të aftësive tregimtare në gjuhën shqipe*.

Udhëzime për përdorimin e testit si mjet vlerësues

Instrumenti vlerësues shumëgjuhësor i aftësive tregimtare në gjuhën shqipe është menduar kryesisht për fëmijët afërsisht 3 deri në 10 vjeç, por mund të përdoret gjithashtu edhe për fëmijët më të rritur, adoleshentët dhe të rriturit. Ai mund të përdoret për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë tregimtare. Gjithashtu, ai lejon mënyra të ndryshme elicimiti (different elicitation modes): Përralla e treguar nga eksperimentuesi (përralla e modeluar), Tregimi e përrallës (e cila nuk është modeluar më parë) dhe Ritregimi (i përrallës së treguar).

Zgjedhja e procedurës së elicimitit (p.sh. përralla e modeluar/ritregim i ndjekur nga tregimi i përrallës, ose vetëm tregimi i përrallës) varet nga qëllimet dhe nevojat e vlerësimit. Vetë ekzaminuesit mund ta përdorin testin sipas qëllimeve të tyre.

Dizajni i *Instrumentit vlerësues shumëgjuhësor të aftësive tregimtare në gjuhën shqipe* lejon vlerësimin e disa gjuhëve tek i njëjti fëmijë. Cilado gjuhë mund të vlerësohet e para. Për fëmijët bilingualë, intervali midis dy gjuhëve duhet të jetë 4 deri në 7 ditë, me qëllim që të minimizohet efekti i trajnimit kur testi bëhet nga njëra gjuhë tek tjetra. Në mënyrë ideale, fëmija nuk duhet të vlerësohet nga i njëjti person në të dyja gjuhët, me qëllim që të arrihet një kontekst njëgjuhësh dhe të mos favorizohet ndërkëmbimi i kodeve gjuhësore.


Materialet

- 4 sekuenca me ilustrime: *Zogjtë e Vegjël, Kecat, Macja dhe Qeni* (tre kopje për secilën përrallë (të printuara me ngjyra), secila kopje në një zarf të veçantë: në total 12 zarfa të veçantë)
- 4 skenare përrallash/tekste stimuluese: *Zogjtë e Vegjël, Kecat, Macja dhe Qeni*
- Pajisje regjistrimi (audio ose video)
- Protokollet e vlerësimit për analizën e makrostrukturës, fjalë të gjendjes së brendshme emocionale dhe pyetje rreth përmbajtjes
- Pyetëtori për të dhënat personale

Udhëzie

Përgatitja e materialeve

1. Për të shkarkuar ilustrimet e nevojshme vizitoni faqen online www.leibniz-zas.de/en/service-transfer/main
2. Printoni çdo skedar PDF (d.m.th. çdo sekuencë/histori të figurës) tre herë, me ngjyra të një printeri me cilësi të mirë, në letër të bardhë A4, secila foto në madhësi 9 x 9 cm.
3. U vini numra ilustrimeve (1-6) nga mbrapa.
4. Prisni me gërshërë ilustrimin në dy radhë.
5. I ngjitni figurat së bashku në një shirit me 6 ilustrime, siç tregohet më poshtë dhe i palosni dy herë (fig. 1, fig. 2, paloseni, fig. 3, fig. 4, paloseni, fig. 5, fig. 6).
Kujdes: Mos prisni dhe mos përdorni figurat e vogla nga udhëzimet për palosjen.



6. Vendoseni secilin ilustrim/ sekuencë (6 figurat) në një zarf të veçantë, me ngjyrë ose një shenjë tjetër dalluese (p.sh. pika) për të identifikuar përrallat.

Kryerja e vlerësimit

- Sigurohuni që ju vetë i njihni mirë protokollet e përrallave dhe udhëzimet.
- Përgatisni pajisjen audio/video për seancën e regjistrimit. Filloni regjistrimin para fazës përgatitore. Sigurohuni që të regjistroni të gjithë seancën, duke përfshirë përgjigjet e fëmijës për pyetjet e të kuptuarit.
- Faza përgatitore duhet të mbështetet në përvojën tuaj paraprake dhe në mjedisin kulturor. Ndërsa flisni me fëmijën, krijoni një lidhje me të dhe bëni disa pyetje për t'u siguruar që fëmija është në gjendje të kuptojë pyetje të thjeshta që fillojnë me ndajfolje pyetëse. Pyeteni fëmijën për shembull: Kush është shoku juaj më i mirë? Çfarë ju pëlqen të shihni në TV? A ju pëlqen të tregoni histori? A ju pëlqen të dëgjoni histori?
- Sigurohuni që të tre zarfet që përmbajnë të njëjtat sekuenca figurash të jenë mbi tavolinë para se të fillojë vlerësimi. (Qëllimi i prezantimit në këtë lloj formati është që fëmija të mendojë se eksperimentuesi nuk e di se çfarë përralle ka në zarfin që ai/ajo ka zgjedhur, duke kontrolluar në këtë mënyrë efektin e njohurisë së përbashkët gjatë prezantimit të sekuecave me ilustrime.)
- Kryejeni vlerësimin sipas udhëzimeve në protokollin e përrallave. Lutemi të mbështeteni te rekomandimet për komentet nxitëse (shihni gjithashtu edhe komentet nxitëse më poshtë).
- Informacion shtesë për prezantimin e figurave: Gjatë eksperimentit, ju duhet të uleni përballë fëmijës në mënyrë që fëmija t'i ketë fotot me fytyrë nga vetja, por larg jush. Kur fëmija të nxjerrë ilustrimet, i thoni të hapë figurat dhe ta shohë të gjithë përrallën, duke filluar që nga figura e parë, dhe thoni: "*Shiko figurat, por mos m'i trego mua. Vetëm TI duhet ta shohësh përrallën.*" (Nëse fëmija nuk arrin t'i hapë vetë ilustrimet, në vend të tij mund t'i mbani ju figurat, por ato duhet të jenë larg jush dhe me fytyrë nga fëmija.)
- Kur fëmija të jetë gati për të treguar përrallën, ndihmoheni t'i palosë figurat përsëri në 3 pjesë. Ju mund të drejtoni procesin e palosjes pa i parë figurat, ndërsa fëmija është akoma duke i mbajtur ato. Udhëzoheni fëmijën të fillojë ta tregojë përrallën ndërsa është duke parë dy figurat e para. Kur ai/ajo ka mbaruar së pari figurat 1 dhe 2, drejtoni shpalosjen e dy figurave të tjera (tani do të jenë të shpalosura figurat 1-4. Kur fëmija të ketë mbaruar, drejtoni shpalosjen e dy figurave të radhës në mënyrë që fëmija tani të ketë të hapur para vetes të gjithë përrallën.
- Kur fëmija të ketë mbaruar së treguari/ritreguari përrallën, filloni pyetjet rreth përmbajtjes duke thënë: "*Tani unë do të bëj disa pyetje për përrallën*". Kur të bëni pyetjet rreth përmbajtjes, mbajini sekuecat e figurave të shpalosura dhe plotësisht të dukshme për fëmijën dhe vlerësuesin në tryezë.
- Pasi të ketë mbaruar sesi, transkriptoni tregimin (tregimet) dhe vlerësoni me pikë prodhimtarinë e fëmijës dhe pyetjet rreth përmbajtjes në fletët e vlerësimit.
- **Mbani mend:** Lista e opsioneve në fletën e vlerësimit nuk është shteruese. Jepen pikë sa herë që një element i makrostrukturës (Qëllim, Përpyetje, Rezultat, Fjalë të gjendjes së brendshme emocionale) shprehet me çfarëdo formulimi të përshtatshëm fjalësh. Konsultohuni me manualin për udhëzime të mëtejshme.

Komentet nxitëse

1. Mos ia filloni përrallën fëmijës, përkundrazi, inkurajoheni fëmijën ta tregojë vetë përrallën, duke i thënë: "*Ma tregon dot përrallën?*" (tregoni me gisht figurën).
2. Bëni komente nxitëse vetëm pasi keni pritur të paktën 10 sekonda dhe vetëm kur duket se fëmija nuk do të thotë asnjë. Vetëm atëherë duhet të nxitet fëmija, në fillim duke thënë "*Në rregull...*", "*Hë...*", "*Radha jote...*". Lutemi të keni SHUMË kujdes me komentet nxitëse me qëllim që të shmangët krijimi i ndryshimeve midis grupeve kërkimore, d.m.th. ndikimi i eksperimentuesit. Prisni afërsisht deri në 10 sekonda; nëse fëmija akoma nuk ka folur, nxiteni duke i thënë: "*Më trego çfarë po ndodh*". Nëse fëmija hesht në mes të përrallës, inkurajoheni të vazhdojë t'ju tregojë më shumë: "*Ndonjë gjë tjetër?*", "*Vazhdo*", "*Më trego më shumë*", "*Të shohim si vazhdon përralla*".
3. Nuk ka rëndësi se si i referohet fëmija protagonistëve të përrallës gjatë rrëfimit; mos e

korrigjoni fëmijën. Nëse fëmija nuk e gjen dot fjalën për një veprim, protagonist etj., dhe duket se ka ngecur ose ju kërkon ndihmë, inkurajojeni duke i thënë “*Mund ta quash si të duash*”, “*Si do t’i thoshe ti?*”.

4. Përmbahuni të mos bëni pyetje të tilla si:
 - a) “*Çfarë po bën këtu ai?*”, “*Kush po vrapon?*” (me qëllim që të mos shpërqendrohet ose ndikohet rrëfimi i fëmijës, dhe të mos inkurajohet përdorimi i fjalive të paplota).
 - b) “*Çfarë është kjo?*”, “*Çfarë/kë sheh në figurë?*” (me qëllim që të shmangen referencat deiktike).
5. Nëse fëmija fillon të tregojë një histori nga përvoja e vet, p.sh., “*Në mëngjes pashë një zog si ky*” ose “*Unë do të shkoj me mamin në dyqan pas shkollës...*”, i jepni pak kohë fëmijës që të flasë për përvojën e vet dhe pastaj me butësi i kërkoni t’ju tregojë përrallën e ilustruar me figura. (Këtë pjesë rrëfimi që nuk është e lidhur me eksperimentin përjashtojeni nga analiza.)
6. Mbështetur në përvojën tuaj të mëparshme dhe në mjedisin kulturor, mund të inkurajoni fëmijën me fjalë si: “*Mirë*”, “*Bukur*”, pas çdo çifti figurash (dhe para se të shpalosni çiftin tjetër të figurave). (Kjo gjithashtu do të ndihmojë transkriptuesin/koduesin të lidhë thëniet me një grup të caktuar figurash.) Nëse ndjeni që kjo shpërqendron tregimin dhe mendimet e fëmijës, mos e bëni këtë.

Si (të mos) krahasohen rezultatet midis tregimeve

- Kur testoni një fëmijë bilingualë në dy gjuhë, shmangni përdorimin e tregimit të Macës dhe/ose Qenit për një gjuhë dhe tregimin e Zogjës të vegjël dhe/ose Kecës për një gjuhë tjetër.
- Gjithashtu shmangni përdorimin e tregimit të Macës dhe/ose Qenit në një pikë testimi dhe krahasimin e tyre me Zogjtë e vegjël dhe/ose Kecat në një pikë tjetër testimi.
- Pse? Historitë e këtij instrumenti nuk mund të krahasohen drejtpërdrejt në çdo mënyrë. Siç kanë treguar rezultatet e fundit, katër historitë ndryshojnë në disa pika, veçanërisht në lidhje me pyetjet e të të kuptuarit. Zogjtë e vegjël dhe Kecat janë afërsisht paralele; Macja dhe Qeni janë gjithashtu paralele, por ndryshojnë nga Zogjtë e vegjël dhe Kecat në disa aspekte, p.sh. tema e tregimit, numri i personazheve dhe disa nga pyetjet e të kuptuarit. Prandaj, sigurohuni që të mos krahasoni mollët me dardhat.
- Gjatë testimit të grupeve të fëmijëve me këtë instrument, sigurohuni që të përdorni procedurat e duhura rradhitjes së tregimeve, në mënyrë që të minimizoni efektet e tregimit dhe/ose efektet e elicimit (ritregim, përralla e modeluar, tregim).

Procedurat e rradhitjes së tregimeve për qëllime kërkimore

Rendi ose rradhtija e paraqitjes së tregimeve/historive duhet të kombinohet sipas a) gjuhës (p.sh. shqip, greqisht, italisht, etj) dhe b) përrallës (Macja/Qeni – (kryesisht) historisë model/ritregim dhe Zogjtë e vegjël/Kecat – (kryesisht) tregim), siç janë paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme. Përdorni procedurën e paraqitur në këtë tabelë më poshtë (nëse testohet vetëm një gjuhë, atëherë përdorni procedurën e zgjedhjes së rastësishme për fëmijët ose ndiqni renditjen me numër 1, 2, 5 dhe 6 ose me numër 3, 4, 7 dhe 8):

Fëmija numër	Gjuha	Përrallë Model/ Ritregim	Tregim i përrallës	Gjuha	Përrallë Model Ritregim	Tregim i përrallës
1	L1	Macja	Zogjtë	L2	Qeni	Kecat
2	L1	Macja	Kecat	L2	Qeni	Zogjtë
3	L2	Macja	Kecat	L1	Qeni	Zogjtë
4	L2	Macja	Zogjtë	L1	Qeni	Kecat
5	L1	Qeni	Zogjtë	L2	Macja	Kecat
6	L1	Qeni	Kecat	L2	Macja	Zogjtë
7	L2	Qeni	Kecat	L1	Macja	Zogjtë
8	L2	Qeni	Zogjtë	L1	Macja	Kecat

Mos harroni që rezultatet e historive a tregimeve të ndryshme dhe rezultatet e mënyrave të elicimitit nuk mund të krahasohen me njëra tjetrën në mënyrë të drejtpërdrejtë (shiko sqarimin e bërë më lart).

Protokolli për Macen

Tregim / Ritregim / Përralla e modeluar

Emri i fëmijës: _____

Datëlindja: _____

Data e testimi: _____

Mosha e testimi (në muaj): _____

Gjinia: _____

Emri i eksperimentuesit: _____

Expozimi ndaj L2 (në muaj): _____

Data e hyrjes në kopsht: _____

Emri i kopshtit: _____

Sigurohuni që të gjithë zarfat të jenë mbi tavolinë para se të fillojë testimi. Përgatitni regjistruarin audio që të regjistrojë sesionin. Filloni regjistrimin para fazës përgatitore.

Faza përgatitore

Bëni pyetje si: Kë ke shok/shoqe të ngushtë? Çfarë ke qejf të shikosh në televizor? Të pëlqen të tregosh përralla? Të pëlqen të dëgjosh përralla?

Udhëzime

Udhëzime për tregimin

Uluni përballë fëmijës. I thoni atij/asaj: “Shiko, këtu janë tri zarfe. Në secilin zarf ka një përrallë të ndryshme. Ti zgjidh njërin prej zarfeve dhe do të më tregosh përrallën që zgjodhe.” I hapni figurat në mënyrë që vetëm fëmija ta ketë para vetes të gjithë ilustrimin. “Në fillim shikoje të gjithë përrallën. Je gati?”

Shpaloseni ilustrimin (i cili duhet të jetë në formë të laminuar) në mënyrë që 2 figurat e para t'i shohë vetëm fëmija. I thoni fëmijës: “*Tani dua që ta tregosh ti përrallën. Shiko figurat dhe ma trego sa më mirë që të mundesh.*” Nëse fëmija ngurron të fillojë, mund ta nxisni: “*Ma trego historinë*” (tregoni me gisht figurën). Kur fëmija të ketë mbaruar së treguari 2 figurat e para, hapni 2 tjerat (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 6). Përsëriteni procesin derisa të arrini në fund të përrallës. Nëse fëmija hesht në mes të përrallës, mund ta nxisni duke i thënë: “Ka më?”, “Vazhdo”, “ Më thuaj më shumë”, “Të shohim çfarë ndodh tjetër në përrallë”. Nëse fëmija pushon së foluri pa treguar që ka mbaruar, i kërkoni: “Më thuaj kur të mbarosh”. Kur fëmija të ketë mbaruar, lavdërojeni dhe pastaj i bëni pyetjet rreth përmbajtjes.

Udhëzime për ritregimin

Uluni përballë fëmijës. I thoni atij/asaj: “Shiko, këtu janë tri zarfe. Në secilin zarf ka një përrallë të ndryshme. Ti zgjidh njërin prej zarfeve dhe unë do të të tregoj përrallën që zgjodhe.” I hapni figurat në mënyrë që vetëm fëmija ta ketë para vetes të gjithë ilustrimin. “Në fillim shikoje të gjithë përrallën. Je gati? Tani unë do të tregoj përrallën dhe pastaj do të ma thuash ti mua.”

Shpalosni figurat 1 dhe 2. Përralla fillon këtu: (tregoni me gisht figurën 1). *Na ishte një herë një mace e shkathët që pa një flutur ulur mbi një shkurre. Macja u hodh sepse donte ta kapte fluturën. Ndërkaq, një djalë i gëzuar po kthehej nga peshkimi me një kovë dhe një top në dorë. Ai pa që macja po ndiqte diçka.*

Shpalosni figurat 3 dhe 4 (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 4). *Djali bërtiti: “Mace, moj mace, çfarë po ndjek ti kështu?” Por flutura fluturoi dhe macja ra në shkurre dhe u vra. Djali u habit dhe i ra topi nga dora. Djali thirri: “O-bo-bo! Më iku topi! dhe vendosi ta marrë prapë topin. Ndërkohë, macja vuri re kovën e djalit dhe mendoi: “Çfarë la djali brenda në kovë?” Ajo pa peshqit dhe donte t’i merrte.”*

Shpalosni figurat 5 dhe 6 (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 6). *Djali filloi të nxirrte topin nga uji. Ndërkaq, macja u zgjat drejt peshqve që la djali dhe mendoi: “Mmm, kushedi sa të shijshëm do të jenë!” Djali ishte i gëzuar që e mori përsëri topin. Ajo nuk e vuri re fare që macja po hante peshkun e shijshëm.*

Dhe ky është fundi i përrallës.

Shpalosni ilustrimin (i cili duhet të jetë në formë të laminuar) në mënyrë që 2 figurat e para t’i shohë vetëm fëmija. I thoni fëmijës: “*Tani dua që ta tregosh ti përrallën. Shiko figurat dhe ma trego sa më mirë që të mundesh.*” Nëse fëmija ngurron të fillojë, mund ta nxisni: “*Ma trego historinë*” (tregoni me gisht figurën). Kur fëmija të ketë mbaruar së treguari 2 figurat e para, hapni 2 tjerat (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 6). Përsëriteni procesin derisa të arrini në fund të përrallës. Nëse fëmija hesht në mes të përrallës, mund ta nxisni duke i thënë: “Ka më?”, “Vazhdo”, “ Më thuaj më shumë”, “Të shohim çfarë ndodh tjetër në përrallë”. Nëse fëmija pushon së foluri pa treguar që ka mbaruar, i kërkoni: “Më thuaj kur të mbarosh”.

Kur fëmija të ketë mbaruar, përgëzojeni dhe pastaj i bëni pyetjet rreth përmbajtjes.

Udhëzime për përrallën e modeluar

Uluni përballë fëmijës. I thoni atij/asaj: “Shiko, këtu janë tri zarfe. Në secilin zarf ka një përrallë të ndryshme. Ti zgjidh njërin prej zarfeve dhe unë do të të tregoj përrallën që zgjodhe.” I hapni figurat në mënyrë që vetëm fëmija ta ketë para vetes të gjithë ilustrimin. “Në fillim shikoje të gjithë përrallën. Je gati? Unë do të të tregoj historinë dhe më pas do të bëj disa pyetje.”

Unë do të të tregoj historinë dhe më pas do të bëj disa pyetje.

Shpalosni figurat 1 dhe 2. Përralla fillon këtu: (tregoni me gisht figurën 1). *Na ishte një herë një mace e shkathët që pa një flutur ulur mbi një shkurre. Macja u hodh sepse donte ta kapte fluturën. Ndërkaq, një djalë i gëzuar po kthehej nga peshkimi me një kovë dhe një top në dorë. Ai pa që macja po ndiqte diçka.*

Shpalosni figurat 3 dhe 4 (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 4). *Djali bërtiti: “Mace, moj mace, çfarë po ndjek ti kështu?” Por flutura fluturoi dhe macja ra në shkurre dhe u vra. Djali u habit dhe i ra topi nga dora. Djali thirri: “O-bo-bo! Më iku topi! dhe vendosi ta marrë prapë topin. Ndërkohë, macja vuri re kovën e djalit dhe mendoi: “Çfarë la djali brenda në kovë?” Ajo pa peshqit dhe donte t’i merrte.”*

Shpalosni figurat 5 dhe 6 (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 6). *Djali filloi të nxirrte topin nga uji. Ndërkaq, macja u zgjat drejt peshqve që la djali dhe mendoi: “Mmm, kushedi sa të shijshëm do të jenë!” Djali ishte i gëzuar që e mori përsëri topin. Ajo nuk e vuri re fare që macja po hante peshkun e shijshëm.*

Dhe ky është fundi i përrallës.

Pasi t’i thoni: “Dhe ky është fundi i përrallës”, bëni pyetjet rreth përmbajtjes.

Fleta e vlerësimit për Macen

Seksioni I: Prodhimtaria

A. Struktura e Përrallës; B. Kompleksiteti Strukturor;

C. Fjalë të Gjendjes së Brendshme Emocionale (Internal State Terms: IST)

A. Struktura e përrallës

		Shembuj përgjigjesh të sakta²	Pikët
A1.	Rrethanat	Përmendje e kohës dhe/ ose vendit, p.sh., një herë e një kohë/ një ditë/ shumë kohë më parë... në një pyll/ në liqen/ buzë lumit...	0 1 2 ³
<i>Episodi 1: Macja (Personazhet e episodit: macja dhe flutura)</i>			
A2.	IST si event iniciues	Macja ishte lozonjare/ kureshtare Macja pa një flutur	0 1
A3.	Qëllim (Q)	Macja donte të kapte/ zinte/ Ndiqte fluturën/ të luante me fluturën	0 1
A4.	Përpjekje (P)	Macja u hodh / kërcëu Macja ndoqi/nisi të ndiqte	0 1
A5.	Rezultat (R)	Macja ra në shkurre/ nuk e kapi fluturën/ macja nuk u tregua shumë e shpejtë Flutura shpëtoi/ fluturoi tutje/ ishte shumë e shpejtë	0 1
A6.	IST si reagim	Macja u zhgënjye/ u inatos/ u mërzit Flutura ishte e lumtur/ e gëzuar	0 1
<i>Episodi 2: Djali (Personazhet e episodit: djali)</i>			
A7.	IST si event iniciues	Djali u trishtua/ u mërzit/ u merakos për topin e vet Djali pa topin në ujë	0 1
A8.	Qëllim (Q)	Djali vendosi/ donte ta merrte topin e vet	0 1
A9.	Përpjekje (P)	Djali po e nxirrte/ po e nxjerr/ u përpoq ta nxirrte topin nga uji	0 1
A10.	Rezultat (R)	Djali e mori topin/ përsëri/ Topi ishte në duar të sigurta	0 1
A11.	IST si reagim	Djali u mërzit/ u lumturua/ u kënaq/u qetësua që arriti të merrte përsëri topin	0 1
<i>Episodi 3: Macja (Personazh i episodit: macja)</i>			
A12.	IST si event iniciues	Macja vuri re/ pa peshkun/ ishte e uritur/ kureshtare	0 1
A13.	Qëllim (Q)	Macja donte/ vendosi ta merrte/ rrëmbente/ hante/ kapte/ vidhte peshkun	0 1
A14.	Përpjekje (P)	Macja e mori/ po e merr/ e rrëmbeu/po e rrëmben/e tërhoqi/po e tërheq/ e vodhi/po e vjedh peshkun	0 1

² Nëse keni dyshime ose nëse përgjigjja e fëmijës nuk është në këtë fletë vlerësimi, konsultohuni me manualin.

³ Zero pikë për përgjigje të gabuar ose kur nuk përgjigjet fare, 1 pikë për përgjigjen e saktë, 2 pikë kur përmend edhe kohën, edhe vendin.

		Macja po e rrëmben/tërheq/merr peshkun(nga kova)/ u zgjat drejt peshkut	
A15.	Rezultat (R)	Macja hëngri/ mori peshkun	0 1
A16.	IST si reagim	Macja ishte e kënaqur/ e gëzuar/e lumtur/ jo e uritur(jo më e uritur)	0 1
A17.	Pikët totale nga 17 të mundshme:		

B. Kompleksiteti strukturor

Numri i sekuencave PR	Numri i Q-ve (pa P ose R)	Numri i sekuencave QP / QR sequences	Numri i sekuencave QPR sequences
B1.	B2.	B3.	B4.

C. Fjalë që shprehin gjendje të brendshme emocionale

C1.	<p>Numri total i fjalëve që shprehin gjendje të brendshme emocionale. Fjalët që shprehin gjendje të brendshme emocionale mund të jenë:</p> <p>Fjalë që shprehin perceptim p.sh. <i>shoh, dëgjoj, ndiej, nuhas;</i></p> <p>Fjalë që shprehin gjendje fiziologjike p.sh. <i>i etur, i uritur, i lodhur, i vrrarë, i lënduar;</i></p> <p>Fjalë që shprehin ndërgjegjësim p.sh. <i>gjallë, zgjuar, i përgjumur;</i></p> <p>Fjalë që shprehin emocione p.sh. <i>i mërzhitur, i lumtur, i zemëruar, i shqetësuar, i zhgënjyer, i frikësuar, krenar, trim, i sigurt, i surprizuar.</i></p> <p>Folje që shprehin një proces mendor p.sh. <i>dua, mendoj, di, harroj, vendos, besoj, habitem, kam/ bëj një plan;</i></p> <p>Folje gjuhësore/ folje të të thënit/ treguarit p.sh. <i>them, thërras, bërtas, paralajmëroj, pyes.</i></p>
-----	---

Seksioni II: Pyetje rreth përmbajtjes

		Shembuj përgjigjesh të sakta	Shembuj përgjigjesh të gabuara	Pikët
0	Të pëlqeu përralla?	Pyetje përgatitore, nuk vlerësohen me pikë		
D1.	Pse kërcen/hidhet macja? (Tregoni me gisht figurat 1-2) (Episodi 1: Qëllim)	Dëshiron/ të marrë/ kapë/ ndjekë fluturën/ të luajë me fluturën	Po largohet/ vrapon/ donte të hidhej Macet janë gjithmonë duke u hedhur/ vrapuar	0 1
D2.	Si ndjehet macja? (Tregoni me gisht fig. 3) (IST si reagim)	E zemëruar/ keq/ e zhgënjyer/ e lënduar/ ka dhimbje/ jo mirë/ jo e qetë	Mirë/ e lumtur	0 1
D3.	<i>(Bëni pyetjen D3 vetëm nëse fëmija jep përgjigjen e saktë pa shpjegim/ arsyetim në D2. Nëse në D2 jepet një shpjegim, atëherë jepni një pikë në D3 dhe vazhdoni në D4.)</i> Pse mendon se macja ndjehet e zemëruar/ e zhgënjyer/e lënduar etj.? ⁴	Sepse nuk e kapi dot fluturën/ ra në shkurre/ kur bie në një shkurre me gjemba, vritesh Flutura shpëtoi/ u largua	Përgjigje e papërshtatshme/ pa lidhje	0 1
D4.	Pse e mban djali kallamin e peshkimit në ujë? (tregoni me gisht fig. 5) (Episodi 2: Qëllim)	Dëshiron/ ta marrë prapë topin e vet	Që të luajë në ujë	0 1
D5.	Si ndjehet djali? (Tregoni me gisht fig. 6) (IST si mënyrë reagimi)	Mirë/ në rregull/ i lumtur/ i kënaqur/	Keq/ i zemëruar/ i mërzhitur/ i trishtuar	0 1
D6.	<i>(Bëni pyetjen vetëm nëse fëmija jep përgjigjen e saktë pa shpjegim/ arsyetim në D5. Nëse në D5 jepet një shpjegim, atëherë jepni një pikë në D6 dhe vazhdoni në D7.)</i> Pse mendon se djali ndjehet mirë/ i lumtur/ kënaqur etj.? ⁵	Sepse ai e ka/ mori/ mund/ arriti të merrte topin përsëri	Sepse po buzëqesh/ ashtu duket/ përgjigje tjetër pa vend	0 1
D7.	Pse i rrëmbeu macja peshqit? (tregoni me gisht fig. 5) (Episodi 3: Qëllim)	Vendosi/ do që të hajë/ marrë/ vjedhë peshqit/ shfrytëzon rastin/ mundësinë kur djali nuk e ka mendjen Nuk kapi fluturën/ Nuk mundi të kapte	Do që të luajë me peshqit	0 1

⁴ Përdorni të njëjtat IST që jepen nga fëmija si përgjigje e D2.

⁵ Përdorni të njëjtat IST që jepen nga fëmija si përgjigje e D5.

		fluturën Peshqit janë të shijshëm		
D8.	Përfytyroni sikur djali e sheh macen. Si ndjehet djali? (Tregoni me gisht fig. 6) (IST si mënyrë reagimi)	Keq/ i zemëruar/ i mërzhitur	Shkëlqyeshëm/ mirë/ i lumtur/ i kënaqur	0 1
D9.	<i>(Bëni pyetjen D9 vetëm nëse fëmija jep përgjigjen e saktë pa shpjegim/ arsyetim në D8. Nëse në D8 jepet një shpjegim, atëherë jepni një pikë në D9 dhe vazhdoni në D10.)</i> Pse mendon se djali ndjehet keq/ i zemëruar/ i mërzhitur etj.? ⁶	Sepse macja hëngri/ po ha/ mori/ ka marrë peshqit Djali donte ta hante vetë peshkun Peshku ishte i djalit	Kallami i peshkimit është përtokë ose përgjigje tjetër pa vend	0 1
D10.	Do të bëhet mik me macen djali? Pse?	Jo – jepni të paktën një arsye (macja hëngri peshqit) ose ndonjë përgjigje tjetër pa vend	Po/ nuk e di/ përgjigje tjetër pa vend	0 1
D11.	Pikët totale nga 10 të mundshme:			

⁶ Përdorni të njëjtat IST që jepen nga fëmija si përgjigje e D8.

Protokolli për Qenin

Tregim / Ritregim / Përralla e modeluar

Emri i fëmijës: _____
Datëlindja: _____
Data e testimit: _____
Mosha e testimit (në muaj): _____
Gjinia: _____
Emri i eksperimentuesit: _____
Expozimi ndaj L2 (në muaj): _____
Data e hyrjes në kopsht: _____
Emri i kopshtit: _____

Sigurohuni që të gjithë zarfat të jenë mbi tavolinë para se të fillojë testimi. Përgatitsni regjistruerin audio që të regjistroni sesionin. Filloni regjistrimin para fazën përgatitore.

Faza përgatitore

Bëni pyetje si: Kë ke shok/shoqe të ngushtë? Çfarë ke qejf të shikosh në televizor? Të pëlqen të tregosh përralla? Të pëlqen të dëgjosh përralla?

Udhëzime

Udhëzime për tregimin

Uluni përballë fëmijës. I thoni atij/asaj: “Shiko, këtu janë tri zarfe. Në secilin zarf ka një përrallë të ndryshme. Ti zgjidh njërin prej zarfeve dhe do të më tregosh përrallën që zgjodhe.” I hapni figurat në mënyrë që vetëm fëmija ta ketë para vetes të gjithë ilustrimin. “Në fillim shikoje të gjithë përrallën. Je gati?”

Shpaloseni ilustrimin (i cili duhet të jetë në formë të laminuar) në mënyrë që 2 figurat e para t'i shohë vetëm fëmija. I thoni fëmijës: “*Tani dua që ta tregosh ti përrallën. Shiko figurat dhe ma trego sa më mirë që të mundesh.*” Nëse fëmija ngurron të fillojë, mund ta nxisni: “*Ma trego historinë*” (tregoni me gisht figurën). Kur fëmija të ketë mbaruar së treguari 2 figurat e para, hapni 2 tjerat (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 6). Përsëriteni procesin derisa të arrini në fund të përrallës. Nëse fëmija hesht në mes të përrallës, mund ta nxisni duke i thënë: “Ka më?”, “Vazhdo”, “ Më thuaj më shumë”, “Të shohim çfarë ndodh tjetër në përrallë”. Nëse fëmija pushon së foluri pa treguar që ka mbaruar, i kërkoni: “Më thuaj kur të mbarosh”.

Kur fëmija të ketë mbaruar, përgëzojeni dhe pastaj i bëni pyetjet rreth përmbajtjes.

Udhëzime për ritregimin

Uluni përballë fëmijës. I thoni atij/asaj: “Shiko, këtu janë tri zarfe. Në secilin zarf ka një përrallë të ndryshme. Ti zgjidh njërin prej zarfeve dhe unë do të të tregoj përrallën që zgjodhe.” I hapni figurat në mënyrë që vetëm fëmija ta ketë para vetes të gjithë ilustrimin. “Në fillim shikoje të gjithë përrallën. Je gati? Tani unë do të tregoj përrallën dhe pastaj do të ma thuash ti mua.”

Shpalosni figurat 1 dhe 2. Përralla fillon këtu: (tregoni me gisht figurën 1). *Na ishte një herë një qen i shkathët që pa një mi ulur pranë një peme. Qeni u hodh sepse donte ta kapte miun. Ndërkaq një djalë i gëzuar po kthehej nga pazari me një çantë dhe një tullumbace në dorë. Ai pa që qeni po ndiqte diçka.*

Shpalosni figurat 3 dhe 4 (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 4). *Djali bërtiti: “Qen, o qen, çfarë po ndjek ti kështu?” Por miu iku me vrap dhe qeni u përplas te pema dhe u vra. Djali u habit dhe i iku tullumbacja nga dora. Djali thirri: “O-bo-bo! Më iku tullumbacja!” dhe vendosi ta marrë prapë tullumbacen. Ndërkohë, qeni vuri re çantën e djalit dhe mendoi: “Çfarë la djali brenda në çantë?” Ai pa salçiqet dhe donte t’i merrte.*

Shpalosni figurat 5 dhe 6 (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 6). *Djali filloi të ulte tullumbacen nga pema. Ndërkaq, qeni u zgjat drejt salsiçeve që la djali dhe mendoi: “Mmm, kushedi sa të shijshme do të jenë!” Djali ishte i gëzuar që e mori përsëri tullumbacen. Ai nuk e vuri re fare që qeni po hante salçiqen e shijshme.*

Dhe ky është fundi i përrallës

Shpalosni ilustrimin (i cili duhet të jetë në formë të laminuar) në mënyrë që 2 figurat e para t’i shohë vetëm fëmija. I thoni fëmijës: *“Tani dua që ta tregosh ti përrallën. Shiko figurat dhe ma trego sa më mirë që të mundesh.”* Nëse fëmija ngurron të fillojë, mund ta nxisni: *“Ma trego historinë”* (tregoni me gisht figurën). Kur fëmija të ketë mbaruar së treguari 2 figurat e para, hapni 2 tjerat (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 6). Përsëriteni procesin derisa të arrini në fund të përrallës. Nëse fëmija hesht në mes të përrallës, mund ta nxisni duke i thënë: “Ka më?”, “Vazhdo”, “ Më thuaj më shumë”, “Të shohim çfarë ndodh tjetër në përrallë”. Nëse fëmija pushon së foluri pa treguar që ka mbaruar, i kërkoni: “Më thuaj kur të mbarosh”.

Kur fëmija të ketë mbaruar, përgëzojeni dhe pastaj i bëni pyetjet rreth përmbajtjes.

Udhëzime për përrallën model

Uluni përballë fëmijës. I thoni atij/asaj: “Shiko, këtu janë tri zarfe. Në secilin zarf ka një përrallë të ndryshme. Ti zgjidh njërin prej zarfeve dhe unë do të të tregoj përrallën që zgjodhe.” I hapni figurat në mënyrë që vetëm fëmija ta ketë para vetes të gjithë ilustrimin. “Në fillim shikoje të gjithë përrallën. Je gati Unë do të të tregoj historinë dhe më pas do të bëj disa pyetje.”

Shpalosni figurat 1 dhe 2. Përralla fillon këtu: (tregoni me gisht figurën 1). *Na ishte një herë një qen i shkathët që pa një mi ulur pranë një peme. Qeni u hodh sepse donte ta kapte miun. Ndërkaq një djalë i gëzuar po kthehej nga pazari me një çantë dhe një tullumbace në dorë. Ai pa që qeni po ndiqte diçka.*

Shpalosni figurat 3 dhe 4 (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 4). *Djali bërtiti: “Qen, o qen, çfarë po ndjek ti kështu?” Por miu iku me vrap dhe qeni u përplas te pema dhe u vra. Djali u habit dhe i iku tullumbacja nga dora. Djali thirri: “O-bo-bo! Më iku tullumbacja!” dhe vendosi ta marrë prapë tullumbacen. Ndërkohë, qeni vuri re çantën e djalit dhe mendoi: “Çfarë la djali brenda në çantë?” Ai pa salçiqet dhe donte t’i merrte.*

Shpalosni figurat 5 dhe 6 (në mënyrë që tani të shihen të gjitha figurat nga 1 deri në 6). *Djali filloi të ulte tullumbacen nga pema. Ndërkaq, qeni u zgjat drejt salsiçeve që la djali dhe mendoi: “Mmm, kushedi sa të shijshme do të jenë!” Djali ishte i gëzuar që e mori përsëri tullumbacen. Ai nuk e vuri re fare që qeni po hante salçiqen e shijshme.*

Dhe ky është fundi i përrallës

Pasi të keni thënë “Dhe ky është fundi i përrallës”, bëni pyetjet rreth përmbajtjes.

Fleta e vlerësimit për Qenin

Seksioni I: Prodhimtaria

- A. Struktura e përrallës; B. Kompleksiteti strukturor;
C. Fjalë të gjendjes së brendshme emocionale (IST)

A. Struktura e përrallës

		Shembuj përgjigjesh të sakta⁷	Pikët
A1.	Rrethanat	Përmendje e kohës dhe/ ose vendit, p.sh., na ishte një herë/ një ditë/ shumë kohë më parë... në një pyll/ park/ lëndinë/ pranë rrugës/ në një fushë/ afër një peme	0 1 2 ⁸
<i>Episodi 1: Qeni (Personazhet e episodit: qeni dhe miu)</i>			
A2.	IST si event iniciues	Qeni ishte i shkathët/ kureshtar/ pa një mi	0 1
A3.	Qëllim (Q)	Qeni donte të kapte/ zinte/ ndiqte miun/ të luante me miun	0 1
A4.	Përpjekje (P)	Qeni kërceu/ u hodh Qeni ndoqi/ filloi të ndiqte	0 1
A5.	Rezultat (R)	Qeni përplasi kokën/ qeni nuk e zuri dot miun/ qeni nuk u tregua dot shumë i shpejtë Miu shpëtoi/ vrapoi prapa pemës/ miu ishte shumë i shpejtë	0 1
A6.	IST si reagim	Qeni u zhgënjye/ zemërua/ vra Miu ishte i lumtur/ i gëzuar/ i lehtësuar	0 1
<i>Episodi 2: Djali (Personazh i episodit: djali)</i>			
A7.	IST si event iniciues	Djali u mërzit/ u shqetësua/ u bë merak për tullumbacen Djali pa tullumbacen në pemë	0 1
A8.	Qëllim (Q)	Djali vendosi/ donte ta merrte përsëri tullumbacen	0 1
A9.	Përpjekje (P)	Djali po e tërhiqte/ u përpoq ta ulte tullumbacen nga pema/ u hodh pas tullumbaces Djali u përpoq të arrinte tullumbacen/ u ngjit/ po ngjitet(në pemë)	0 1
A10.	Rezultat (R)	Djali e mori tullumbacen/ përsëri/ tullumbacja ishte në duar të sigurta	0 1
A11.	IST si reagim	Djali ishte i gëzuar/ i lumtur/ i kënaqur që e mori tullumbacen	0 1
<i>Episodi 3: Qeni (Personazh i episodit: qeni)</i>			
A12.	IST si event iniciues	Qeni pa/ vuri re salsiçet në çantë/ ishte i uritur/ kureshtar	0 1
A13.	Qëllim (Q)	Qeni donte/ vendosi t'i merrte/ rrëmbente/ hante/ vidhte salsiçet	0 1

⁷ Nëse keni dyshime ose nëse përgjigjja e fëmijës nuk është në këtë fletë vlerësimi, konsultohuni me manualin.

⁸ Zero pikë për përgjigje të gabuar ose kur nuk përgjigjet fare, 1 pikë për përgjigjen e saktë, 2 pikë kur përmend edhe kohën, edhe vendin.

A14.	Përpjekje (P)	Qeni i mori/ rrëmbeu/ vodhi salsiçet nga çanta Qeni po merr/ po rrëmben/ po vjedh salçiçet(nga çanta)	0 1
A15.	Rezultat (R)	Qeni i hëngri/ i mori salsiçet	0 1
A16.	IST si reagim	Qeni ishte i kënaqur/ gëzuar/ jo i uritur	0 1
A17.	Pikët totale nga 17 të mundshme:		

B. Kompleksiteti strukturor

Numri i sekuencave PR	Numri i Q-ve (pa P ose R)	Numri i sekuencave QP / QR sequences	Numri i sekuencave QPR sequences
B1.	B2.	B3.	B4.

C. Fjalë që shprehin gjendje të brendshme emocionale

C1.	<p>Numri total i fjalëve që shprehin gjendje të brendshme emocionale. Fjalët që shprehin gjendje të brendshme emocionale mund të jenë:</p> <p>Fjalë që shprehin perceptim p.sh. <i>shoh, dëgjoj, ndiej, nuhas;</i></p> <p>Fjalë që shprehin gjendje fiziologjike p.sh. <i>i etur, i uritur, i lodhur, i vrrarë, i lënduar;</i></p> <p>Fjalë që shprehin ndërgjegjësim p.sh. <i>gjallë, zgjuar, i përgjumur;</i></p> <p>Fjalë që shprehin emocione p.sh. <i>i mërzitur, i lumtur, i zemëruar, i shqetësuar, i zhgënjyer, trim, i frikësuar, i surprizuar, krenar</i></p> <p>Folje që shprehin një proces mendor p.sh. <i>dua, mendoj, di, harroj, vendos, besoj, habitem, kam/ bëj një plan;</i></p> <p>Folje gjuhësore/ folje të të thënit/ treguarit p.sh. <i>them, thërras, bërtas, paralajmëroj, pyes.</i></p>
-----	---

Seksioni II: Pyetje rreth përmbajtjes

		Shembuj përgjigjesh të sakta	Shembuj përgjigjesh të gabuara	Pikët
0	Të pëlqeu përralla?	Pyetje përgatitore, nuk vlerësohen me pikë		
D1.	Pse kërcen/hidhet qeni?(Tregoni me gisht figurat 1-2) (Episodi 1: Qëllim)	Dëshiron/ të marrë/ kapë/ ndjekë miun/ të luajë me miun	Po largohet/ vrapon/ do që të hidhet/ kështu hidhen qentë	0 1
D2.	Si ndjehet qeni? (Tregoni me gisht fig. 3) (IST si reagim)	I zemëruar/ keq/ i zhgënjyer/ i lënduar	Mirë/ i lumtur	0 1
D3.	<i>(Bëni pyetjen D3 vetëm nëse fëmija jep përgjigjen e saktë pa shpjegim/ arsyetim në D2. Nëse në D2 jepet një shpjegim, atëherë jepni një pikë në D3 dhe vazhdoni në D4.)</i> Pse mendon se qeni ndjehet e zemëruar/ e zhgënjyer/e lënduar etj.? ⁹	Sepse nuk e kapi dot miun/ përplasi kokën në pemë Të dhemb koka kur e përplas në pemë Miu shpëtoi/ u largua	Përgjigje e papërshtatshme/ pa lidhje	0 1
D4.	Pse hidhet djali? (Tregoni me gisht fig. 5) (Episodi 2: Qëllim)	Dëshiron/ ta marrë përsëri tullumbacen e tij/ sepse i iku tullumbacja	Që t'i ngjitet pemës/ të ngjitet në pemë	0 1
D5.	Si ndjehet djali? (Tregoni me gisht fig. 6) (IST si reagim)	Mirë/ në rregull/ i lumtur/ i kënaqur	Keq/ i zemëruar/ i mërziur/ i trishtuar	0 1
D6.	<i>(Bëni pyetjen vetëm nëse fëmija jep përgjigjen e saktë pa shpjegim/ arsyetim në D5. Nëse në D5 jepet një shpjegim, atëherë jepni një pikë në D6 dhe vazhdoni në D7.)</i> Pse mendon se djali ndjehet mirë/ i lumtur/ kënaqur etj.? ¹⁰	Sepse ai e ka/ mori përsëri tullumbacen e vet	Sepse po buzëqesh/ ashtu duket/ po rri në këmbë/ përgjigje tjetër pa vend	0 1
D7.	Pse i rrëmben qeni salsiçet? (Tregoni me gisht fig. 5) (Episodi 3: Qëllim)	Vendosi/ do që të hajë/ marrë/ vjedhë salsiçet Përfitoi nga mosvëmendja e djalit Nuk mundi të kapë miun Qentë i pëlqejnë salsiçet	Do që të luajë me çantën	0 1

⁹ Përdorni të njëjtat IST që jepen nga fëmija si përgjigje e D2.

¹⁰ Përdorni të njëjtat IST që jepen nga fëmija si përgjigje e D5.

		Salsiçet janë të shijshme		
D8.	Përfytyroni sikur djali e sheh qenin. Si ndjehet djali? Tregoni me gisht fig. 6) (IST si mënyrë reagimi)	Keq/ i zemëruar/ i mërzitur	Shkëlqyeshëm/ mirë/ i lumtur/ i kënaqur	0 1
D9.	<i>(Bëni pyetjen D9 vetëm nëse fëmija jep përgjigjen e saktë pa shpjegim/ arsyetim në D8. Nëse në D8 jepet një shpjegim, atëherë jepni një pikë në D9 dhe vazhdoni në D10.)</i> Pse mendon se djali ndjehet keq/ i zemëruar/ i mërzitur etj. ¹¹	Sepse qeni ia hëngri/ ia mori salsiçet Djali i donte salsiçet për vete Ato ishin salsiçet e djalit	Përgjigje e papërshtatshme	0 1
